



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-2146/1 nga 14.03.2022, me tregues të rrethanave lidhur me shkaqet e mundshme të zjarrit, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e detyrave zyrtare dhe kompetencave publike.

KSHPK-ja denoncimin do ta dërgon në MPB, me qëllim që informacionet në denoncim të mirën parasysh nëse ndermirën veprime sipas denoncimit të dorëzuar.

Lënda me numër 12-2146/1 nga 14.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet..

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më 14 mars 2022, një parashtrues i panjohur ka dorëzuar denoncim që përmban të dhëna për rrethanat në lidhje me shkaqet e mundshme të zjarrit dhe është formuar lënda me numër 12-2146/1 i datës 14 mars 2022.

Në denoncim, parashtruesi, pa raportuar veprime konkrete të personave të caktuar, kërkon ///, ish-drejtor i AD /// (AD ///), të thirret në bisedë në lidhje me zjarrin në objektet e AD // /, sepse, siç thuhet në denoncim, shkaqet e zjarrit mund të konstatohen nga dëshmia e personit të treguar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se denoncimi përmban një tregues që nuk i referohet veprimeve që nënkuptojnë korrupsion në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke marrë parasysh kompetencat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, KSHPK vlerëson se ekziston mundësia që Ministria të ketë ndërmarrë veprime në lidhje me rastin e përshkruar në denoncim.

Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, dhe raportin do ta dorëzojë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në mënyrë që të dhënat e përfshira në të të merren parasysh nëse ndërmerren veprime në lidhje me rastin e përshkruar në denoncim.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Përpiloi: A.R.M.

Miratoi: S.P.D., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska